

Vendim nr. 104 datë 17.05.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahim, i,	Anëtar

në datën 17.05.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (E) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ENDRI MULLAI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 3219 (80-2022-3284), datë 01.12.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Rikthimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Kolegji), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në cilësinë e Autoritetit Kontraktor (AK), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka hapur procedurën e prokurimit me nr. REF-98548-06-18-2021 me objekt: “Loti I:

Rehabilitim i hidrovorit të Karavastasë”, me fond limit 276.589.335 lekë pa TVSH, e cila është zhvilluar në datën 13.07.2021 ku ka marrë pjesë vetëm bashkimi i operatorëve ekonomikë “Shëndelli” sh.p.k. & “G.P.G. Company” sh.p.k., i cili është shpallur fitues. Në këtë procedurë prokurimi kërkuesi ka qenë një ndër anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), në cilësinë e juristit.

2. Në datën 26.11.2021 Agjencia e Prokurimit Publik (APP) ka nisur me iniciativë të saj hetimin administrativ për procedurën e prokurimit, duke i kërkuar AK-së dokumentacionin e plotë të administruar që nga planifikimi deri te nënshkrimi i kontratës, përfshirë dokumentacionin e dorëzuar në formë shkresore përpara lidhjes së kontratës nga operatori ekonomik i shpallur fitues.

3. Me shkresën nr. 7980/1, datë 09.12.2021, AK-ja ka dërguar dokumentacionin përkatës. Në kushtet e konstatimit të mungesave në dokumentet e dorëzuara, APP-ja ka kërkuar plotësimin e tij. Dokumentacioni i kërkuar është dërguar me shkresën nr. 120/1, datë 13.01.2022 të AK-së.

4. Pas përfundimit të verifikimit të zbatimit të procedurës së lartpërmendur, me shkresën nr. 4402/5, datë 09.03.2022, APP-ja i ka dërguar AK-së gjetjet e saj për procedurën e prokurimit, duke kërkuar nga personat përgjegjës, sipas konstatimeve, që të paraqesin kundërshtime nëse kanë, së bashku me dokumentacion provues. Në kushtet kur disa nga anëtarët që kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit nuk ishin më pjesë e stafit të saj, si dhe nisur nga volumi i raportit të APP-së, AK-ja ka kërkuar shtyrjen e afatit të paraqitjes së kundërshtimeve me 7 ditë dhe në datën 19.04.2022 ka dërguar kundërshtimet së bashku me dokumentacionin përkatës.

5. Me vendimin nr. 74, datë 05.07.2022, APP-ja ka vendosur dënimin me gjobë në masën 140.000 lekë të secilit prej anëtarëve të njësisë së prokurimit, për mospërmbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (ligji nr. 162/2020), si dhe dënimin me gjobë në masën 180.000 lekë të secilit prej anëtarëve të KVO-së, për mospërmbushje të detyrimeve të përcaktuara në nenet 77 (“Kërkesat për kualifikim”) dhe 92 (“Shqyrtimi i ofertave”) të këtij ligji.

6. Në datën 25.08.2022 kërkuesi dhe anëtarët e tjerë të KVO-së e të njësisë së prokurimit publik të dënuar me gjobë me vendimin e AKKP-së, i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për shfuqizimin e vendimit nr. 74, datë 05.07.2022 të APP-së, duke pretenduar se: përmes shpalljes së ofertave në vlerat më të ulëta i kanë kursyer buxhetit të shtetit një vlerë të madhe monetare; sugjerimet e APP-së të

paraqitura në AK në lidhje me kriteret e kualifikimit, janë parë nga njësia e prokurimit, e cila, përmes një *e-mail*-i zyrtar, ka vendosur t'i pranojë pjesërisht ato, duke publikuar shtojcën përkatëse në sistemin elektronik të prokurimeve publike, sipas parashikimeve ligjore në fuqi dhe, pas modifikimeve të kryera, APP-ja nuk ka bërë sugjerime të mëtejshme; me veprimet ose mosveprimet e tyre nuk është shkaktuar diskriminim i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe APP-ja nuk ka paraqitur asnjë fakt, provë ose rrethanë, e cila mund të sillte rrethanë rënduese për konkurrentët; APP-ja nuk ka mundur të faktojë dëmin e shkaktuar nga njësia e prokurimit dhe KVO-ja, si rrjedhojë e hapave të ndjekur ose vlerën e tij.

7. Me vendimin nr. 3219 (80-2022-3284), datë 01.12.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova dhe se kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Sipas gjykatës, nga aktet shkresore të paraqitura në cilësinë e provës nga palët dhe të administruara gjatë gjykimit, ka rezultuar e provuar se AK-ja ka shkelur dispozitat ligjore dhe aktet e tjera normative në fuqi, pasi: nuk ka administruar dosjen e tenderit, projektet dhe specifikimet teknike të procedurës së prokurimit; nuk ka argumentuar dhe dokumentuar përllogaritjen e fondit limit; nuk ka evidentuar personin përgjegjës për prokurimin dhe specialistët e fushës; disa nga kriteret e kualifikimit nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit publik; nuk është mbajtur në konsideratë plotësimi nga operatori ekonomik i kryerjes së pagesave, sipas ligjit për sistemin e taksave vendore; nuk janë dhënë arsye konkrete lidhur me kërkesën për paraqitjen nga operatorët ekonomikë të faturave tatimore për çdo situacion; nuk ka argumentuar kërkesën për inxhinier mjedisi me zërat konkretë të punimeve mjedisore të parashikuara në preventivin e punimeve; nuk ka argumentuar kërkesën që drejtuesi teknik të jetë në marrëdhënie pune me shoqërinë për një periudhë jo më pak se një vit, si dhe paraqitjen e listëpagesave për minimalisht tre muajt e fundit etj.

8. Në datën 31.03.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të lartpërmendur, duke pretenduar se i kanë cenuar të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkuetit

9. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

9.1. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtarja e çështjes është bërë palë me APP-në, duke mbështetur tërësisht vendimin e saj në pretendimet e parashtruara nga APP-ja. Ajo ka mbajtur qëndrim pro këtij subjekti, duke u shprehur se ai dhe kërkuesit e tjerë në gjykim nuk provonin dot pafajësinë.

9.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi në hetimin administrativ APP-ja nuk ka dëgjuar pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Po kështu, gjyqtarja e çështjes nuk ka dëgjuar pretendimet e tij dhe të kërkuesve të tjerë, nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura dhe nuk i ka lënë të japin pretendimet përfundimtare.

9.3. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi vendimi i gjykatës është i paargumentuar dhe kopje e vendimit të APP-së. Gjyqtarja e çështjes nuk ka dhënë asnjë argument se përse vendimi i APP-së është i drejtë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1,

shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me kontrollin subsidiar që ushtron Gjykata, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit (*shih vendimet nr. 4, datë 22.02.2022; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, kërkuuesi ka kundërshtuar vendimin e Gjykatës e Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i cili, sipas nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 është i paankimueshëm, për shkak të vlerës së vogël të padisë. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se kërkuuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

14. Për sa i takon legjitimitimit *ratione temporis*, Kolegji konstaton se vendimi i kundërshtuar mban datën 01.12.2022, ndërsa kërkuuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual në datën 31.03.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, së drejtës për t’u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit. Për sa i takon pretendimit për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, Kolegji vlerëson se kërkuuesi nuk ka arritur ta ngrejë atë në nivel kushtetues, në drejtim të testit objektiv dhe subjektiv të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 24, datë 11.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*), duke mos arritur të provojë në nivel kushtetues paanshmërinë e gjyqtarës në raport me të drejtën e saj për të vlerësuar çështjen sipas bindjes së saj të brendshme, në kuptim të nenit 137 të Kushtetutës.

Ndërkohë, pretendimet e tjera, të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues, do të analizohen në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u dëgjuar

16. Kërkuesi ka pretenduar se në hetimin administrativ APP-ja nuk ka dëgjuar pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Po kështu, gjyqtarja e çështjes nuk ka dëgjuar pretendimet e tij dhe të kërkuesve të tjerë, nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura dhe nuk i ka lënë të japin pretendimet përfundimtare.

17. Neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese dhe ato ligjore nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e tyre, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta e individit për proces të rregullt ligjor nuk kufizohet vetëm në procesin gjyqësor, por përfshin edhe atë me karakter administrativ. Në këtë kuptim, çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij kushtetuese e ligjore, është i detyruar të respektojë standardet që lidhen me procesin e rregullt, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit me faktet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, nëpërmjet dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për proces të rregullt ligjor. Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur (*shih vendimin nr. 17, datë 23.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar se parametrat kushtetues që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor, në radhë të parë, duhet të parashikohen nga legjislacioni procedural dhe, më pas, duhet të përmbushen nga organet e administratës publike nëpërmjet zbatimit të dispozitave ligjore, konkretisht të Kodit të Procedurës Administrative. Në këtë këndvështrim, kur ankimi kushtetues individual ka në objektin e tij mënyrën se si kanë vepruar organet e pushtetit publik, atëherë kontrolli kushtetues ushtrohet për të verifikuar nëse organi administrativ ka përmbushur detyrimet ligjore në atë masë që të jetë respektuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt ligjor dhe, në vijim, nëse gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar veprimet dhe vendimmarrjen e organit administrativ, kanë vepruar në përputhje me parimin e subsidiaritetit, sipas të cilit, siç

është pohuar edhe në jurisprudencën kushtetuese, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është, në radhë të parë, funksion i gjykatave të zakonshme (*shih vendimin nr. 38, datë 02.12.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, për sa u përket pretendimeve të kërkuarit se në hetimin administrativ APP-ja nuk ka dëgjuar pretendimet e operatorëve ekonomikë, Kolegji vëren se neni 129 i ligjit nr. 162/2020, i cili përcakton procedurën në lidhje me këtë hetim, në pikën 2 parashikon në mënyrë alternative veprimet hetimore që ky organ ka të drejtë të kryejë, ku në shkronjën “ç” përcaktohet e drejta e tij për të marrë në pyetje çdo person që është i lidhur me çështjen nën hetim dhe të thërrasë të gjithë personat pa imunitet. Në kuptim të këtij neni, thirrja e një personi për t’u dëgjuar në lidhje me një procedurë prokurimi vlerësohet nga APP-ja rast pas rasti, duke qenë e varur kryerja e një veprimi të tillë hetimor nga lidhja dhe rëndësia e të dhënave që deklarimet e personit mund të sjellin në raport me faktet dhe rrethanat objekt i hetimit administrativ.

20. Nga ana tjetër, për sa i përket pretendimit të kërkuarit se gjyqtarja e çështjes nuk ka dëgjuar pretendimet e tij dhe të kërkuarëve të tjerë, nuk ka marrë parasysh provat e paraqitura dhe nuk i ka lënë të japin pretendimet përfundimtare, në analizë të përmbajtjes së vendimit gjyqësor, Kolegji konstaton se, në kundërshtim nga sa pretendohet, gjykata ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuarit dhe të personave të tjerë të dënuar nga APP-ja për procedurën e prokurimit në fjalë dhe ka argumentuar gjetjet e saj, duke marrë në analizë si pretendimet e kërkuarit, ashtu edhe ato të APP-së për secilën gjetje.

21. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit

22. Kërkuari ka pretenduar se vendimi i gjykatës është i paargumentuar dhe kopje e vendimit të APP-së. Gjyqtarja e çështjes nuk ka dhënë asnjë argument se përse vendimi i APP-së është i drejtë.

23. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik,

i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata e juridiksionit të zakonshëm për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Zbatimi i këtij standardi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre (*shih vendimin nr. 9, datë 23.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se gjatë shqyrtimit të kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesit, përfshirë dhe kërkuesin në rastin konkret, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka analizuar dhe vlerësuar dispozitat ligjore në fuqi, aktet e tjera normative në lidhje me prokurimet, si dhe pretendimet e tyre në raport me ato të parashtruara nga APP-ja, duke dhënë përgjigje të arsyetuar për çdo konkluzion të arritur prej saj. Po kështu, vendimi i saj përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e organit administrativ, shkaqet e ngritura në kërkesëpadi, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku ajo mbështet qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë alogjik, kontradiktor ose i paqartë në përmbajtjen dhe vlerësimin e bërë.

27. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se vendimi objekt kërkeje nuk cenon kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për arsyetimin e tij. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

28. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.